Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1051
Data e Vendimit: 09.01.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) Kompania e Sigurimit Alpha Private Security SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 09/01/2024, mori këtë:

Vendim

1.Hedhet si e palejuar-jo e plotë, ankesa e OE Kompanisë së Sigurimit Alpha Private Security SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/1051, e datës 26/12/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së", me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1, inicuar nga MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME nga cilësia e saj si autoriteti kontraktues (AK).

2.I lejohet, AK–MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së", me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 26/12/2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE Kompania e Sigurimit Alpha Private Security SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit me "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1", inicuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, në

cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesës së lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyra për pranimin e ankesave me datën 27.12.2023 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës së cekur si më lart nuk i ka bashkangjitur formularin për sigurim të depozitës të Ankesës, ta plotësoj ankesën sipas nenit 111 të LPP në të kundërtën hedhet si e palejuar ankesa. Por, edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi të OSHP-së, OE ankues nuk ka kompletuar ankesën sipas kërkesës së institucionit.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE Kompania e Sigurimit Alpha Private Security SH.P.K., e datës 26/12/2023 (protokoll 1051/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në ketë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së", me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 24-2, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **Kompani E Sigurimit Alpha Private Security SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: